

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6592
E martë, 26 prill 2022
çmimi 0.40

PDK-ja: Komisioni Parlamentar duhet t'i hetojë lidhjet e qeverisë me "Kartelin e rrymës" FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NDIHMËSSEKRETARJA AMERIKANE E SHTETIT PËR ÇËSHTJE EVROPIANE DHE EUROAZIATIKE, KAREN DONFRIED, TË HËNËN KA VIZITUAR KOSOVËN FAQE 4

NDIHMËSSEKRETARJA AMERIKANE: SHBA-ja I JEP PRIORITET DIALOGUT



Ndihmëssekretarja amerikane e Shtetit për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike, Karen Donfried, ka thënë të hënën se Kosova dhe Serbia duhet të angazhohen në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian në Bruksel, sepse status quoja është e paqëndrueshme. Ajo i ka bërë këto deklarata në Prishtinë pas takimit që ka zhvilluar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. "Ne i japim prioritet mbështetjes së procesit të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe t'i ndihmojmë Kosovës që t'i normalizojë marrëdhëniet me Serbinë duke pasur në qendër njohjen e ndërsjellë", ka thënë Karen Donfried

AKTUALE



UKRAINA KËRKON PAJISJE PËR CENTRALET BËRTHAMORE F. 2

MBI 400 RASTE AKTIVE ME COVID NË KOSOVË F. 3

SPECIALIZANTËT PARALAJMËROJNË PADI KUNDËR MINISTRISË SË SHËNDETËSISË F. 6

EKONOMI



FATURAT E RRYMËS S'ULEN, BETEJA VAZHDON NË GJYKATË F. 7

DELEGACIONI I BQK-së PËRFUNDON PJESËMARRJEN NË TAKIMET PRANVERORE TË FMN-së DHE BB-së F. 7

SPORT



FATURAT E RRYMËS S'ULEN, BETEJA VAZHDON NË GJYKATË F. 11

Rasti i ambasadorit Berishaj, pyet Haradinaj: Ku janë kufijtë moralë të Kurtit dhe Osmanit FAQE 5



AVOKATI I AKREDITUAR I SPECIALES: PO ZVARRITET PROCEDURA NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-së NË HAGË FAQE 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Liderët botërorë urojnë Macronin për rizgjedhje

PARIS, 25 PRILL - Udhëheqësit botërorë uruan presidentin e Francës, Emmanuel Macron, për rizgjedhjen e tij në zgjedhjet e së dielës. "Ne mund të mbështetemi te Franca edhe për pesë vjet të tjerë", shkroi presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, në "Twitter". "Franca është aleatja jonë më e vjetër dhe një partnere kyçe në adresimin e sfidave globale", ka shkruar presidenti amerikan Joe Biden në "Twitter".

Kancelari gjerman Olaf Scholz tha se votuesit francezë "kanë dhënë një votë të fortë besimi

për Evropën". "Jam i lumtur që do ta vazhdojmë bashkëpunimin tonë të mirë", tha ai.

Kryeministri britanik Boris Johnson e cilësoi Francën si një nga aleatët më të afërt dhe më të rëndësishëm. "Mezi pres të vazhdojmë të punojmë së bashku për çështjet që kanë shumë rëndësi për dy vendet tona dhe për botën", tha Johnsoni në mesazhin e urimit për Macronin.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i cili ka biseduar disa herë me

Macronin qëkur Rusia ka nisur pushtimin e vendit të tij më 24 shkurt, tha se e ka uruar homologun francez gjatë një bisede telefonike. "E vlerësoj mbështetjen e tij dhe jam i bindur se po ecim së bashku drejt fitoreve të reja të përbashkëta", shkroi Zelensky në "Twitter".

Kryeministri i Australisë, Scott Morrison, tha se fitorja e Macronit është një "shprehje e madhe e demokracisë liberale në një kohë të pasigurt".

Macron, pro-evropian, mundi rivalen e ekstremit të djathtë,



Marin Le Pen, në rundin e dytë të zgjedhjeve që u mbajt të dielën. Sipas rezultateve

zyrtare, ai fitoi rreth 58.6 për qind të votave, ndërsa Le Pen 41.4 për qind.

Rusia dëbon 40 diplomatë gjermanë

MOSKË, 25 PRILL - Rusia ka shpallur 40 diplomatë gjermanë persona të padëshiruar, ka thënë Ministria e Jashtme ruse, duke urdhëruar kështu dëbimin e tyre. Ky vendim është parë si shenjë hakmarrjeje ndaj vendimit të njëjtë të Berlinit për të dëbuar numër të njëjtë të diplomatëve rusë nga Gjermania më 4 prill.

Ministria e Jashtme ruse ka thënë se i ka dërguar ambasadorit gjerman në Moskë një letër proteste për politikën armiqësore të Berlinit si dhe kundërshtimin për



dëbimin e 40 diplomatëve rusë në fillim të muajit prill.

Sipas agjencisë së lajmeve dpa, kjo shifër përbën një të tretën e

stafit diplomatik gjerman në Rusi.

Ministrja e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock, ka thënë

se Gjermania e ka pritur këtë vendim, mirëpo ka shtuar se ai nuk "arsyetohet asesi".

Të 40 diplomatët rusë të dëbuar tri javë më parë "nuk kanë kryer asnjë ditë shërbim diplomatik gjatë qëndrimit të tyre në Gjermani", ka thënë ajo përmes një deklarate. "Këta njerëz kanë punuar në mënyrë sistematike kundër lirisë tona dhe kundër kohezionit në shoqërinë tonë për vite".

Baerbock ka thënë se puna e tyre ka kërcënuar njerëzit që kanë kërkuar mbrojtje në Gjermani, duke thënë se një qasje e tillë nuk mund të

tolerohet më.

Diplomatët e dëbuar nga Rusia "nuk janë fajtorë për asgjë", ka thënë ajo, duke shtuar se ata kanë shkuar në Rusi për marrëdhënie bilaterale. "Me dëbimet e kryera sot, Rusia është duke dëmtuar veten edhe më shumë".

Shtetet evropiane kanë dëbuar më shumë se 300 anëtarë të ambasadave ruse prej kur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës.

Rusia është përgjigjur duke dëbuar diplomatë të Shteteve të Bashkuara dhe të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Ukraina kërkon pajisje për centralet bërthamore

KIEV, 25 PRILL - Ukraina i kërkoi Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore (ANE) një listë të pajisjeve, që janë të nevojshme për funksionimin e sigurt të objekteve të saj bërthamore.


Sipas njoftimit të postuar në uebfaqen e ANE-it, lista përmend në mënyrë specifike instrumente matëse të

rrezatimit, materiale mbrojtëse, sisteme të energjisë elektrike dhe generatorë me naftë.

ANE ka dërguar pajisje në Ukrainë muajin e kaluar, thuhet në njoftim, ndërsa pjesa tjetër pritet të dorëzohet kur drejtori i përgjithshëm i agjencisë ta vizitojë termocentralin bërthamor të Çernobilit këtë

javë.

Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Forcat e saj kanë marrë fillimisht kontrollin e dy termocentraleve bërthamore në Ukrainë - Zaporizhjas dhe Çernobilit - por më pas ato janë kthyer sërish nën kontrollin forcave ukrainase. Në fillim të marsit bombardimet e ushtrisë ruse



kanë goditur centralin bërthamor të Zaporizhjas, i cili është më i madhi në Evropë.

Siguria e njesisë, megjithatë, nuk është dëmtuar dhe nivelet e rrezatimit kanë mbetur normale.

Atëbotë, ANE ka thënë se ka vendosur qendrat për incidente dhe emergjenca në gatishmëri të lartë.

Robert Golob mposht kryeministrin slloven Jansha

LUBJANË, 25 PRILL - Lëvizja për Liri e biznesmenit liberal Robert Golob ka shënuar fitore ndaj tri herë kryeministrin Janez Jansha në Slloveni dhe Partisë Demokratike Sllovene që ai udhëheq.

Golob, partia e të cilit është themeluar në muajin janar, ka fituar 34.5 për qind të votave në zgjedhjet e 24 prillit, në krahasim me partinë e Janshas që ka fituar 23.5 për qind të

votave, sipas Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili ka numëruar 98 për qind të votave.

Vetëm tri parti të tjera, ajo konservatore, Sllovenia e Re, Social-Demokratët dhe e majta, Levica, kanë marrë më shumë se 4 për qind të votave - minimumi që duhet për të hyrë në parlament.

Golob pritet ta krijojë shumicën me Social-Demokratët dhe të

bëhet kryeministër i ri i shtetit. Jansha, një admirues i ish-presidentit amerikan Donald Trump, është akuzuar nga opozita gjatë fushatës zgjedhore se ka tentuar t'i dëmtojë institucionet demokratike dhe lirinë e medie.

Golob, 55-vjeçar, inxhinier karizmatik, është zotuar në fjalimin e tij të fitores, se rezultatet "do të na mundësojnë t'ia kthejmë lirinë shtetit".



Rasti i ambasadorit Berishaj, pyet Haradinaj: Ku janë kufijtë moralë të Kurtit dhe Osmanit

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 PRILL - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka folur për rastin e ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, për të cilin së fundi është raportuar për përfshirjen e tij në një "skandal financiar".

Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook", duke përmendur disa çështje në lidhje me ambasadorin Berishaj, ka pyetur se ku janë kufijtë moralë të kryeministrit Albin Kurti dhe të presidentes Vjosa Osmani. "1. Presidentja të

sqarojë se me çfarë motivacioni i ka dhënë shtetësinë Ambasadorit Martin Berishaj, me procedura të përsheptuara? A i ka lënë kohë të mjaftueshme AKI-së për të verifikuar aktivitetin e ambasadorit? 2. Përderisa kryeministri Kurti e kishte cilësuar kompaninë GEN si kompani mafioze të nivelit ballkanik, dhe duke pasur parasysh se pronari i saj, sipas tij, është nip i Jovica Stanishiqit, shefit famkeq të sigurimit serb, cila është kundërvlera e blerjes së energjisë pikërisht nga kjo kompani, sapo erdhi në pushtet?", ka shkruar

Haradinaj.

Ai ka pyetur se a janë në dijeni Osmani dhe Kurti, se ambasadori Berishaj nuk e ka deklaruar në formularin e pasurisë kompaninë e tij në Mal të Zi. "3. A janë në dijeni Presidentja dhe Kryeministri se Ambasadori i tyre, nuk e ka deklaruar në formularin e pasurisë kompaninë e tij në Mal të Zi, tanimë e famshme për transacionin me kompaninë, sipas Kurtit të nipit të Stanishiqit? 4. A është pikërisht frika se po zbulohet ky skandal, shkak se përse Vetëvendosje e ka bllokuar formimin e komisionit hetimor parlamentar për blerjen e



energjisë? 5. A po pengohen organet e rendit dhe drejtësisë të veprojnë sipas ligjit në këtë skandal?", ka deklaruar ish-kryeministri Haradinaj.

Ai ka shtuar se nëse jemi në pritje të një epilogu eventual të organeve të drejtësisë, pyetja e tij është e thjeshtë: A kanë kufij moralë këta (Osmani e Kurti)?

UNICEF-i dhe OBSH-ja: Të rritet shkalla e vaksinimit për t'u mbrojtur nga sëmundjet e mundshme serioze

PRISHTINË, 25 PRILL - UNICEF-i dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë kanë bërë thirrje për shtimin e përpjekjeve për t'u siguruar të gjithë qytetarët e Kosovës që t'i marrin vaksinat. Kjo thirrje vjen në kuadër të Javës Botërore të Imunizimit që festohet çdo vit gjatë javës së fundit të prillit. "Kjo javë bën bashkë partnerët për ta promovuar dhënien e vaksinave për t'i mbrojtur personat e të gjitha moshave nga sëmundjet. Udhëhequr nga UNICEF-i dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë, tema e Javës Botërore të Imunizimit për këtë vit është 'Jetë e gjatë për të gjithë'. Tema e këtij viti u përzgjedh për t'i nxjerrë në pah arritjet historike në fushën e vaksinimit përreth botës. Për më shumë se dy shekuj vaksinat kanë ndihmuar që fëmijët dhe të rriturit të mbrohen nga sëmundjet serioze dhe vdekjeprurëse. Vaksinat janë një

nga arritjet më të avancuara të shkencës moderne, me ndihmën e të cilave është arritur që të përgjysmohet vdekshmëria e fëmijëve dhe të shpëtohen miliona jetë në botë", thuhet në njoftimin për medie.

Po në njoftim thuhet se derisa rikujtojmë ndikimin historik të vaksinave, tani bota gjendet në një udhëkryq. "Në aspektin global, pandemia Covid-19 ka paraqitur një ngarkesë të madhe mbi sistemet dhe shërbimet shëndetësore, gjë që paraqet kërcënim për progresin e arritur deri më tani në imunizimin rutinë në botë, përfshirë edhe Kosovën. Një shifër alarmuese prej 23 milionë fëmijësh nuk janë vaksinuar në vitin 2020. Ky numër mund të zvogëlohet vetëm nëpërmjet një angazhimi më të madh dhe investimit në shërbimet e imunizimit nga ana e të gjithëve", thuhet në njoftim.



Kosova ka ende mangësi të theksuara për sa i përket imunizimit rutinë. Vetëm një në 3 fëmijë apo 73 % e fëmijëve janë plotësisht të vaksinuar. "Kjo javë bën bashkë partnerët për ta ëromovuar dhënien e vaksinave për t'i mbrojtur personat e të gjitha moshave nga sëmundjet. Udhëhequr nga UNICEF-i dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë, tema e Javës Botërore të Imunizimit për këtë vit është #Jetë e gjatë për të gjithë. Tema e këtij viti u përzgjedh për t'i nxjerrë në pah arritjet historike në fushën e vaksinimit përreth botës. Për më shumë se dy shekuj vaksinat

kanë ndihmuar që fëmijët dhe të rriturit të mbrohen nga sëmundjet serioze dhe vdekjeprurëse. Vaksinat janë një nga arritjet më të avancuara të shkencës moderne, me ndihmën e të cilave është arritur që të përgjysmohet vdekshmëria e fëmijëve dhe të shpëtohen miliona jetë në botë", thuhet në njoftimin për medie.

Më tej në njoftim thuhet se derisa rikujtojmë ndikimin historik të vaksinave, tani bota gjendet në një udhëkryq. "Në aspektin global, pandemia Covid-19 ka paraqitur një ngarkesë të madhe mbi sistemet dhe shërbimet shëndetësore, gjë që paraqet kërcënim për progresin e arritur deri më tani në imunizimin rutinë në botë, përfshirë edhe Kosovën. Një shifër alarmuese prej 23 milionë fëmijësh nuk janë vaksinuar në vitin 2020. Ky numër mund të zvogëlohet vetëm nëpërmjet një angazhimi më të madh dhe

investimit në shërbimet e imunizimit nga ana e të gjithëve", thuhet në njoftim.

Kosova ka ende mangësi të theksuara për sa i përket imunizimit rutinë. Vetëm një në 3 fëmijë apo 73 % e fëmijëve janë plotësisht të vaksinuar. "Që nga fillimi i vitit 2021, OKB-ja ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë për t'i dhënë mbështetje Kosovës në aspektin e planifikimit dhe shtrirjes së vaksinimit kundër Covid-19, duke përfshirë trajnimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe krijimin e vendeve të caktuara për vaksinim. Përkundër përpjekjeve kolektive, me mbulim vaksinimi prej 50-përqindësh deri më tani (të paktën me një dozë), kosovarëve u kërkohet ta rritin shkallën e vaksinimit për t'u mbrojtur nga sëmundjet e mundshme serioze", thuhet në njoftimin për medie.

Arrestohet personi i cili goditi me veturë një këmbësore në Fushë-Kosovë



FUSHË-KOSOVË, 25 PRILL - Policia e Kosovës ka njoftuar të hënën se ka arritur ta identifikojë personin i cili dje me veturë ka goditur një këmbësore në Fushë-Kosovë, më pas ka ikur nga vendi i ngjarjes. "Sot rreth orës 09:40, nga Njësi i

hetimeve të Trafikut Rajonal të Prishtinës, është identifikuar personi dhe automjeti që ka qenë i përfshirë në aksidentin e ndodhur dje në rrugën Prishtinë-Fushë Kosovë, ku është lënduar rëndë një këmbësore. Fillimisht nga

hetuesit është përcjellje automjeti i dyshuar, derisa ka arritur në një autoservis në Çagllavicë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Në njoftim theksohet se ka qenë reagimi i shpejtë i hetuesve ai që ka mundësuar arrestimin e

personit të dyshuar si dhe konfiskimin e automjetit të tipit "Opel Corsa" i cili ishte dëmtuar. "Pas përfundimit të procedurave të nevojshme policore, rasti do të përcillet në koordinim me prokurorin e shtetit", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Mbi 400 raste aktive me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 25 PRILL - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të hënën se pas 900 testeve, tetë qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të hënën janë shëruar edhe 22 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 224 418.

Në total numri i rasteve aktive është 448.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 17 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha

qytetet e Kosovës janë dhënë 1 825 396 doza të vaksinës.

Deri më sot 821 764 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 101 202 doza përforcuese



dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



NDIHMËSSEKRETARJA AMERIKANE E SHTETIT PËR ÇËSHTJE EVROPIANE DHE EUROAZIATIKE, KAREN DONFRIED, TË HËNËN KA VIZITUAR KOSOVËN

Ndihmëssekretarja amerikane: ShBA-ja i jep prioritet dialogut

Ndihmëssekretarja amerikane e Shtetit për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike, Karen Donfried, ka thënë të hënën se Kosova dhe Serbia duhet të angazhohen në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian në Bruksel, sepse status quoja është e paqëndrueshme. Ajo i ka bërë këto deklaratë në Prishtinë pas takimit që ka zhvilluar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. “Ne i japim prioritet mbështetjes së procesit të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe t’i ndihmojmë Kosovës që t’i normalizojë marrëdhëniet me Serbinë duke pasur në qendër njohjen e ndërsjellë”, ka thënë Karen Donfried

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 25 prill - Ndihmëssekretarja amerikane e Shtetit për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike, Karen Donfried, ka thënë të hënën se Kosova dhe Serbia duhet të angazhohen në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian në Bruksel sepse status quoja është e paqëndrueshme. Ajo i ka bërë këto deklaratë në Prishtinë pas takimit që ka zhvilluar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. “Ne i japim prioritet mbështetjes së procesit të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe t’i ndihmojmë Kosovës që t’i normalizojë marrëdhëniet me Serbinë duke pasur në qendër

njohjen e ndërsjellë. Status quo-ja është paqëndrueshme. Jo vetëm që e pengon të ardhmen evropiane të Kosovës dhe të Serbisë, mirëpo nga kjo përfiton Kremli. Rusia dëshiron të shkatërrojë çdo unitet dhe konsolidim demokratik në Ballkanin Perëndimor”, ka thënë Karen Donfried. Ajo ka bërë me dije se me Kurtin ka diskutuar për hapat e ardhshëm të dialogut dhe rëndësinë e përparimit në këtë proces. Donfried ka biseduar për dialogun edhe me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani. Presidentja Osmani ka thënë se me zyrtaresh amerikane ka biseduar për urgjencën dhe nevojën për përparim në dialog, ndonëse ka theksuar se

marrëdhëniet e Kosovës me aleatët ndërkombëtarë nuk duhet të përcaktohen nga dialogu me Serbinë. “Ritheksova se Kosova është dhe vazhdon të jetë palë konstruktive në dialog dhe se mbesim të përkushtuar ndaj këtij procesi që në qendër ka njohje reciproke, dhe nga ajo do të përfitojnë qytetarët tanë”, ka deklaruar ajo. Osmani, po ashtu, ka thënë se gjatë diskutimeve ka përmendur “zhgënjimin për moszbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara në Bruksel dhe refuzimin e Serbisë për shpërbërjen e strukturave ilegale të cilat vazhdojnë t’i frikësojnë serbët e Kosovës dhe të cilat udhëhiqen nga individë të sanksionuar nga ShBA-ja”. Donfried ka thënë se viziton

Ballkanin Perëndimor në një kohë sfiduese, duke iu referuar luftës së paprovokuar të Rusisë në Ukrainë, e cila ka nisur më 24 shkurt.

Mes të tjerash, zyrtarja amerikane ka thënë se dëshiron ta sigurojë secilin qytetar të Kosovës që mund të jetë i shqetësuar për situatën e sigurisë, se ShBA-ja vazhdon të mbetet aleate e fuqishme dhe ka përmendur KFOR-in (misionin paqeruajtës të NATO-s), si manifestim i përkushtimit amerikan për sigurinë në Kosovë.

Kurti ka thënë se për ruajtje të paqes dhe stabilitetit afatgjatë është e domosdoshme që vendet e Ballkanit Perëndimor të anëtarësohen në Bashkimin Evropian dhe NATO.

Donfried ka përsëritur se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara për ta ndihmuar Kosovën në rrugën drejt institucioneve evropiane dhe euroatlantike. “Është shumë e rëndësishme dhe urgjente të punojmë për të siguruar që Kosova dhe fqinjët e saj të vazhdojnë të bëjnë reformat e domosdoshme për konsolidimin demokratik dhe integrimin e tyre në

institucionet evropiane dhe euroatlantike”.

Përveç fushës së sigurisë, ajo ka përmendur përkushtimin e ShBA-së për ta ndihmuar Kosovën edhe në fusha të tjera. “Është e qartë për mua se resursi kryesor i Kosovës është diçka që duhet të mbrohet, fuqia juaj e re punëtore. Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të jenë me ju derisa zgjeroni ekonominë tuaj, zgjeroni integrimin rajonal dhe ndërtoni një sektor të energjisë të fuqishëm dhe divers”, ka deklaruar Donfried.

Ndihmëssekretarja amerikane e Shtetit për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike, Karen Donfried, do të qëndrojë për vizitë në Ballkanin Perëndimor nga 25 deri më 29 prill. Pas Kosovës, ajo viziton Serbinë, Bosnjë-Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Javën e kaluar Kosovën e ka vizituar edhe një delegacion senatorësh amerikanë: Jeanne Shaheen, Chris Murphy dhe Thom Tillis. Ata kanë thënë se Shtetet e Bashkuara mbështesin aspiratat e Kosovës që të anëtarësohet në NATO dhe Bashkimin Evropian.

Avokati i akredituar i Speciales: Po zvarritet procedura ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë

PRISHTINË, 25 PRILL - Avokati i akredituar nga Gjykata Speciale, Artan Qerkini, vlerëson se është duke u zvarritur procedura ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa kritikon prokurorinë për vonesë të dorëzimit të provave.

Qerkini thotë se prokuroria ka zhvilluar hetime edhe para themelimit të gjykatës andaj, sipas tij, kanë pasur kohë të mjaftueshme për finalizimin e hetimeve të tyre. "Procedura është duke u zvarritur, nuk ka pasur nevojë që prokuroria të vonohet kaq shumë në dorëzimin e provave të mbrojtjes sepse dihet që mbrojtja nuk mund t'i fillojë hetimet e veta pa e marrë gjithë dosjen të cilën e ka në dispozicion prokuroria. Dihet se veprimet hetimore në rastet e Dhomave të Specializuara janë zhvilluar edhe para se të themelohet vetë gjykata, por edhe pasi është aprovuar ligji, kështu që ata kanë pasur mjaft kohë që t'i zhvillojnë të gjitha

hetimet edhe në momentin kur ngrihet aktakuza, mbrojtjes t'ia dorëzojnë të gjitha provat të cilat i kanë në dispozicion, si ato shfajësuese, po ashtu edhe ato provat të cilat ata i konsiderojnë si fajësuese. Kështu që mosveprimi i prokurorisë në kohën e duhur me këto vonesa po ndikon që procedura të zvarritet dhe të shkelet ai standardi kushtetues për gjykimin e një personi brenda afatit të arsyeshëm", thotë Qerkini.

Në një intervistë për "KosovaPress", avokati thotë se lidhur me vonesën e prokurorisë duhet të reagojë gjyqtari i procedurës paraprake dhe, sipas tij, t'u vendosë palëve afate për veprimet e tyre procedurale të cilat do të ishin në funksion të shpejtësisë së procedurës. "Gjyqtari i procedurës paraprake duhet t'i kontrollojë veprimet e prokurorisë që t'i sanksionojë në një mënyrë ose tjetër neglizhimet që është duke i bërë prokuroria me

rastin e dorëzimit të provave, të përcaktojë afate strikte dhe të përcaktojë se nëse prokuroria nuk i dorëzon provat brenda afatit të caktuar, atëherë ato prova të mos pranohen sepse ne e dimë se gjykimi zhvillohet për të zbuluar të vërtetën. Por, janë disa nene, disa parime që e favorizojnë gjykimin brenda afatit të arsyeshëm dhe detyra e gjyqtarit të procedurës paraprake është të gjejë një balancë mes vërtetimit të fakteve me relevancë dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm", thotë ai.

Përveç vonesave nga ana e prokurorisë, Qerkini vlerëson se ekipeve mbrojtëse u janë krijuar edhe vështirësi të tjera të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në punën e tyre në terren. "Mbrojtja duhet ta dijë identitetin e dëshmitarit. Këtë po e them për faktin se mbrojtja nuk mund ta sfidojë me sukses kredibilitetin e dëshmitarit nëse nuk e di se kush po dëshmon. Kjo thjesht e cenon edhe një prej parimeve

fundamentale të procedurës penale që është barazia e 'armëve' në procedurë, sepse prokuroria po e di identitetin e dëshmitarit, ndërsa mbrojtja nuk po e di identitetin e dëshmitarit, edhe pse kjo është e një rëndësie substanciale për dhënien e një mbrojtje efektive", thotë Qerkini.

Në rastin paragjyqësor ndaj Thaçit dhe të tjerëve deri tani janë mbajtur disa konferenca mbi ecurinë e çështjes.

Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli e Rexhep Selimi po qëndrojnë në qendrën e paraburgimit në Hagë prej nëntorit të vitit 2020 dhe mbi ta rëndojnë akuza nën pretendimin për krime lufte.

Përveç këtij rasti i cili është në procedurë paraprake, në Dhomat e Specializuara në Hagë është drejt fundit procesi gjyqësor ndaj Salih Mustafës.

Lidhur me këtë rast Artan Qerkini vlerëson se seancat e mbyllura dhe redaktimet e shumta kanë pamundësuar që të përcillet në tërësi ky proces.

"Ka pasur shumë seanca private, seanca të mbyllura për publikun dhe në ato seanca të mbyllura për publikun ne nuk kemi pasur qasje dhe nuk mund ta formojmë bindjen tonë se çka ka ndodhur në ato seanca, ka pasur shumë redaktime dhe këto po ia pamundësojnë opinionit që ta përcjellë gjykimin dhe vetë opinionit të ketë një përshtypje në lidhje me faktin se a është provuar fajësia apo jo dhe për këtë arsye mendoj që opinionit ka mbetur i hendikepuar që ta përcjellë rastin e Salih Mustafës në tërësinë e tij", thotë ai.

Në Gjykatën Speciale është në procedurë paraprake edhe rasti ndaj ish-pjesëtarit të UÇK-së, Pjetër Shala, për të cilin prokuroria pretendon të ketë kryer krime lufte.

Ndërsa në pritje të një aktgjykimi janë ish-krerët e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati e Nasim Haradinajt, të cilët akuzohen për pengim të drejtësisë.



Kurti me ambasadorët e Quintit diskuton për zhvillimet politike në vend

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministrin e parë, Besnik Bislimi dhe shefin e stafit të kryeministrit, Luan Dalipi, priti të hënën në takim ambasadorët e vendeve të Quintit dhe shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë: ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeffrey Hovenier, ambasadorin e Gjermanisë, Jorn Rohde, të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jacob Webber, ambasadorin e Francës, Marie-Christine Butel, ambasadorin e Italisë, Antonello De Riu dhe përfaqësuesin e posaçëm dhe shefin e Misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog. Në takim u diskutua për zhvillimet politike në vend dhe për situatën politike në rajon. Dy muaj pas fillimit të invazionit dhe agresionit të pprovokuar

ushtarak rus ndaj Ukrainës, nevoja për bashkërendim të qëndrimeve dhe të veprimeve të botës demokratike kundrejt Federatës Ruse mbetet e domosdoshme. "Reagimi dhe rreshtimi i Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe Britaninë e Madhe ka qenë i menjëhershëm. Përveç sanksioneve të vendosura ndaj Federatës Ruse, në linjë me ato të BE-së dhe ShBA-së, Kosova, po ashtu, është solidarizuar me popullin ukrainas duke shprehur gatishmërinë e saj që të mirëpresë deri në 5 000 refugjatë nga Ukraina teksa gazetarja e parë ukrainase nga 20 sosh që do t'i pranojë Kosova tashmë ka arritur në Prishtinë", ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Gjatë takimit u fol edhe për procesin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, për çka Qeveria e Republikës së Kosovës është e angazhuar që të jetë parimor dhe i balancuar për marrëveshje me njohjen reciproke në qendër.



PDK-ja: Komisioni Parlamentar duhet t'i hetojë lidhjet e qeverisë me "Kartelin e rrymës"



PRISHTINË, 25 PRILL (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e konsideron të domosdoshëm formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për krizën energjetike në vend dhe i fton të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, pa dallime partiake, që ta mbështesin këtë iniciativë që ka për qëllim kryesor transparencën e plotë para qytetarëve të Kosovës rreth shpenzimit të mbi 100 milionë eurove nga qeveria aktuale për blerje të energjisë elektrike gjatë krizës dhe shtrenjtimin e saj për qytetarët e Kosovës. "Krahas hetimit të plotë parlamentar, Partia Demokratike e Kosovës kërkon që presidentja dhe

kryeministri të veprojnë me urgjencë për ta larguar nga detyra ambasadorin Martin Berishaj dhe për të zbardhur deri në detaje përfshirjen e tij në 'Kartelin e rrymës', ndërlidhjet me kompaninë energjetike GEN-i me adresë në Serbi, si dhe për t'i zbuluar arsyet e fshehjes së deklarimit të pasurisë nga ana e tij", thuhet në komunikatën e PDK-së. Partia Demokratike e Kosovës i ka bërë thirrje kryeministrit dhe bashkëpunëtorëve të tij që ta ndalojnë pengimin e formimit të Komisionit Hetimor Parlamentar i cili do të zbardhë para opinionit publik shpenzimin e parasë së qytetarëve të Kosovës dhe lidhjet

potenciale të "Kartelit të rrymës" me Qeverinë e Kosovës gjatë krizës energjetike. "Një hetim parlamentar, transparent dhe i hapur, ku do të përfshiheshin deputetët e pozitës dhe të opozitës, tanimë është interes kombëtar. Ky Komision Hetimor Parlamentar do të monitorohet nga ekspertë e anëtarë të shoqërisë civile dhe mediet, ku të gjithë do të shohin se ku, si dhe kujt u janë dhënë mbi 100 milionë euro të taksave të qytetarëve dhe si ndodhi që, krahas shpenzimit të mbi 100 milionë eurove, qytetarëve të Kosovës sërish iu ngrit çmimi i energjisë elektrike për më shumë se 100 për qind", ka njoftuar PDK-ja.

Specializantët paralajmërojnë padi kundër Ministrisë së Shëndetësisë

PRISHTINË, 25 PRILL - Specializantët e të gjitha klinikave të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës kanë shprehur pakënaqësi për pagesat e kujdestarive. Duke i konsideruar këto pagesa si jo të barabarta dhe në kundërshtim me Ligjin e Punës, ata po paralajmërojnë edhe padi kundër Ministrisë së Shëndetësisë. Përfaqësuesi i Këshillit të Specializantëve, Urim Çerkini, ka thënë për "KosovaPress" se, krahas organizimeve të tyre

sindikale dhe takimeve me ministrin e Shëndetësisë, Rifat Latifi, përveç premtimeve, ende nuk ka reflektim për problemet e tyre. Çerkini ka treguar se shqetësim i tyre kryesor është pagesa e ulët e kujdestarive gjatë fundjavës, të cilat po u paguhen sikurse kujdestaritë gjatë ditëve të punës, ndërsa kërkesë e vazhdueshme e specializantëve me vetëfinancim mbetet kthimi i tyre në specializantë të rregullt. "Shqetësimi ynë si mjekë

specializantë është çështja e kujdestarive të fundjavave të cilat nga Ministria e Shëndetësisë paguhen njëjtë sikurse ato të ditëve të punës dhe sikurse ato të fundjavës e që është shkelje e Ligjit të Punës dhe për të cilin jemi konsultuar me juristin e Odës së Mjekëve të Kosovës. Nëse asnjë nga format e organizimit tonë nuk do të ketë sukses, atëherë jemi të detyruar që të ushtrojmë padi kundër Ministrisë së Shëndetësisë për shkelje të Ligjit të Punës", ka thënë Çerkini.



Faturat e rrymës s'ulen, beteja vazhdon në gjykatë

PRISHTINË, 25 PRILL - Me gjithë urdhrin e Gjykatës Themelore në Prishtinë për ta pezulluar vendimin për shtrenjtimin e rrymës - të marrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji - qytetarët e Kosovës edhe këtë muaj janë faturuar me çmime të rritura.

"Faturat kanë ardhur - të papërbalueshme, çmimi është i lartë", thotë Shemsi Kastrati, banor në Prishtinë.

Gjykata ka marrë vendim për pezullim më 9 prill, dy muaj pas hyrjes në fuqi të vendimit për shtrenjtimin e rrymës.

Procesi ka nisur në gjykatë pas padisë së ngritur nga Partia Demokratike e Kosovës, me arsyetimin se shtrenjtimi i rrymës "i dëmton qytetarët".

Procesi gjyqësor vazhdon ende, por deri në vendimin përfundimtar gjykata ka thënë se faturat me rritje duhet të pezullohen.

ZRRE-ja, duke u thirrur në Ligjin për konfliktet administrative, thotë se "aktvendimi i shkallës së parë nuk bëhet i formës së prerë dhe praktikisht nuk është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm".

Neni 66 i këtij Ligji, në të cilin bazohet ZRRE-ja, thotë se "vendimet e gjykatës mund të ekzekutohen atëherë kur bëhen të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme".

Sipas Ehat Miftarajt, jurist në Institutin për Drejtësi të Kosovës, ZRRE-ja është duke e interpretuar gabimisht këtë nen. "Qëllimi i masës së sigurisë, në këtë rast masës së përkohshme [apo vendimit për pezullim] që ka marrë gjykata, është që të parandalohet një dëm apo pasojë që mund të shkaktohet. Nuk do të kishte kuptim kjo masë nëse nuk do të ishte obligative apo e ekzekutueshme për organet

administrative, në këtë rast për ZRRE-në", thotë Miftaraj për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas tij, neni 66, në të cilin thirret ZRRE-ja, është për aktgjykime që merren në bazë të meritës, pra janë finale. "Aktgjykimi merret kur gjykata vendos në bazë të meritës, pra pasi që i ka shtjelluar provat, dëshmitarët dhe të gjitha... Aktvendimi ka të bëjë me caktimin e një mase të sigurisë ndaj një vendimi që gjykata vlerëson se, sikur të zbatohet, do t'i kufizojë dhe shkelë liritë dhe të drejtat e qytetarëve të Kosovës", shpjegon Miftaraj.

ZRRE-ja ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit për këtë rast. Nga kjo zyrë kanë thënë për "Radion Evropa e Lirë" se janë duke prituri vendimin që mund të marrë Apeli, pastaj do të veprojnë në përputhje me të. Deri atëherë nuk do të ndryshojë mënyra e faturimit, kanë paralajmëruar nga ZRRE-ja. ZRRE-ja, në vazhden e krizës globale energjetike, ka miratuar faturat me rritje më 8 shkurt, të cilat ka thënë se do të jenë të vlefshme deri më 31 mars 2023.

Me këto tarifa konsumatorët që shpenzojnë mbi 800 kilovatë rrymë në muaj paguajnë më shtrenjtë. Ata paguajnë 12.5 centë për kilovat gjatë tarifave të shtrenjta, ndërsa 5.9 centë gjatë tarifave të ulëta.

Tarifa e lirë e energjisë elektrike në Kosovë vlen nga 1 tetori deri më 31 mars, nga ora 22:00 deri në orën 7 të mëngjesit.

Nga 1 prilli deri më 30 shtator, tarifa e lirë vlen nga ora 23:00 deri në 8 të mëngjesit. Sipas llogaritjeve të ZRRE-së, rreth 20 për qind e konsumatorëve shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë në muaj.

Për konsumatorët që shpenzojnë më pak, çmimi i rrymës nuk ka ndryshuar - ata vazhdojnë të paguajnë 7 centë për kilovat gjatë



tarifave të shtrenjta dhe 3 centë gjatë tarifave të lira.

Partia Demokratike e Kosovës, e cila ka nisur betejën ligjore kundër vendimit për shtrenjtimin e rrymës, dorëzoi të premten në Prokurorinë Speciale të Kosovës kallëzim penal ndaj anëtarëve të bordit të ZRRE-së. Sipas sqarimit të dhënë, kallëzimi penal është ngritur për shkak të "moszbatimit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë për pezullimin e zbatimit të vendimit të ZRRE-së për shtrenjtimin e energjisë elektrike".

Kallëzimi penal u dorëzua nga

Faton Fetahu, avokat i angazhuar nga PDK-ja, parti opozitare në Kuvendin e Kosovës.

Fetahu tha se me moszbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, bordi i ZRRE-së ka kryer veprat penale: "moszekutim i vendimit të gjykatës, mosrespektim i gjykatës dhe keqpërdorim i pozitës së autoritetit zyrtar". Sipas tij, baza ligjore në të cilën thirret ZRRE-ja është e paqëndrueshme. "Ata [ZRRE] nuk e kanë të qartë dallimin mes aktgjykimit dhe aktvendimit. Në rrethana të rastit konkret është një masë e

përkohshme për shtyrje të zbatimit të vendimit të ZRRE-së", tha Fetahu.

Zyrtarë të ZRRE-së nuk kanë pranuar të komentojnë mbi kallëzimin penal të PDK-së. Kur e ka marrë vendimin për shtrenjtim të rrymës, ZRRE-ja ka thënë se është ndikuar nga rritja e çmimeve të energjisë në nivel botëror.

Marrë parasysh faktin se Kosova nuk prodhon mjaftueshëm energji elektrike, ajo është detyruar të importojë rrymë me çmime më të shtrenjta dhe kjo është reflektuar pastaj edhe në faturat e reja për qytetarët.

Delegacioni i BQK-së përfundon pjesëmarrjen në takimet pranverore të FMN-së dhe BB-së

PRISHTINË, 25 PRILL - Delegacioni i lartë i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga guvernatori Fehmi Mehmeti, përmbylli pjesëmarrjen në takimet pranverore të organizuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Në këto takime që u mbajtën në Uashington të ShBA-së në formë fizike u dha mbështetja për punën e deritashme të BQK-së dhe angazhimet e mëtutjeshme.

Zëvendës drejtori menaxhues i Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bo Li, ka theksuar mbështetjen e mëtutjeshme për BQK-në edhe në të ardhmen.

Gjatë qëndrimit në takimet pranverore guvernatori Mehmeti takoi drejtorin e Departamentit Evropian të Fondit Monetar



Ndërkombëtar, Alfred Kammer, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit makroekonomike si dhe për zhvillimet në sistemin financiar të Kosovës, i cili po vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në

mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit.

Ndërkohë Udabir S. Das nga Departamenti i Politikave Monetare dhe Tregjeve të Kapitalit të Fondit Monetar Ndërkombëtar ka dhënë mbështetje për ofrimin e

asistencave teknike për realizimin e rekomandimeve të dala nga Shqyrtimi i Stabilitetit të Sistemit Financiar (Financial System Stability Review-FSSR).

Gjithashtu, ekipi i Departamentit të Politikave Monetare dhe Tregjeve të Kapitalit vlerësoi realizimin nga BQK të disa prej rekomandimeve të dala nga ky raport.

Guvernatori Mehmeti u takua edhe me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën të udhëhequr nga Gabriel Di Bella, si dhe me drejtorin e Konstituencës në Fond, Daniel Palotai.

Në takimin me zëvendëspresidentin e Bankës Botërore për Evropën dhe Azinë Qendrore, Anna Bjerde, u diskutua për mbështetjen e mëtutjeshme të BQK-së përmes projekteve të

ndryshme, me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit financiar në Kosovë.

Gjatë qëndrimit në Uashington, guvernatori Mehmeti u takua me drejtorin ekzekutiv të konstituencës së Bankës Botërore, Hayrettin Demircan, si dhe mori pjesë në takim me ministrat dhe guvernatorët ku temë diskutimi ishte perspektiva dhe sfidat e politikave për Evropën.

Takimet pranverore të Bordit të Guvernatorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bordit të Guvernatorëve të Grupit të Bankës Botërore mbledhin së bashku bankierë qendrorë, ministrat e financave dhe zhvillimit, drejtuesit e sektorit privat, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile dhe akademikë.



Si mund t'i kundërvihet Bashkimi Evropian ndikimin rus në Ballkan

Nga Margit WUNSCH
GAARMANN “
London School of Economics”

Pushtimi rus i Ukrainës, e ka forcuar vendosmërinë e evropianëve për të mbrojtur demokracinë dhe arkitekturën evropiane të sigurisë. Njëherazi, shumë politikanë dhe akademikë i kanë kthyer sytë nga Ballkani, të frikësuar se çfarë është në gjendje të bëjë ndikimi rus në një rajon të karakterizuar nga destabiliteti politik, problemet ekonomike dhe emigrimi i më të arsimuarve.

Situata bëhet edhe më shqetësuese për shkak të tensioneve të vazhdueshme etnike, të cilat mbeten të pazgjidhura edhe pas rreth 3 dekadash nga shpërbërja e Jugosllavisë. Mundësia e një pushtimi rus në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor – Shqipëri, Bosnje Hercegovinë, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbi – janë të ulëta.

Sidomos për shkak se Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, janë tashmë anëtare të NATO-s. Megjithatë, Rusia mund të vazhdojë ta destabilizojë lehtësisht rajonin, dhe në këtë mënyrë të sabotojë gjasat që 6 vendet të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian, të cilën ato e aspirojnë që nga viti 2005.

Tashmë janë ngritur pikëpyetje se si Bosnja mund të anëtarësohet një ditë në BE-së, kur Milorad Dodik po ndjek aspiratat separatiste të mbështetura nga Rusia për Republikën Srpska (entiteti me shumicë serbe në Bosnje Hercegovinë). Ndërkohë

aspiratat e Kosovës mbeten të bllokuara nga refuzimi i disa vendeve – përfshirë Rusinë dhe Serbinë – për të njohur pavarësinë e saj.

Serbia, që tashmë është kualifikuar si një kandidat për anëtarësim në BE, vazhdon të qëndrojë në një ekuilibër delikat midis përafërimit të saj me politikën e jashtme të BE-së, dhe lidhjeve të saj kulturore dhe historike me “vëllanë e saj sllav”, Rusinë.

Ky tension ishte i dukshëm gjatë një konference për mediat që dha presidenti serb Aleksandar Vucic së bashku me Ministren e Jashtme gjermane Annalena Baerbock më 11 mars, kur Vucic refuzoi të përmendte pushtimin rus, duke aluduar në mënyrë të paqartë për “atë që po ndodh në Ukrainë”.

Brenda vendit, ai ka mbështetje për ruajtjen e marrëdhënieve më të ngushta me Rusinë, siç tregohet nga një sondazh i fundit nga Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë, i cili zbuloi se 54 për qind e qytetarëve serbë e shohin Rusinë si një aleate, 95 për qind si një partnere të domosdoshme, dhe vetëm 11 për qind e shohin BE-në si aleate. Po çfarë mund të bëjë BE-ja në këto kushte? Që nga fillimi i luftës së Rusisë kundër Ukrainës, politikanët evropianë kanë theksuar në mënyrë të përsëritur se ata e shohin të ardhmen e këtij rajonit brenda BE-së, duke deklaruar se një “perspektivë e bazuar në merita

e anëtarësimit të plotë në BE për Ballkanin Perëndimor, është ende pjesë e politikës së sigurisë dhe e interesit ekonomik të unionit”.

Presidenca çeke e BE-së, që do të nisë në korrik 2022, ka të ngjarë të ketë si prioritet çështjen e zgjerimit të unionit në Evropën Juglindore. Megjithatë, fjalët duhet të pasohen nga veprimet konkrete. Në vend se të zvogëlohet mekanizmi kryesor i politikës së zgjerimit (Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimit), siç u vendos gjatë ciklit buxhetor 2021-2027, fondet për rajonin duhet të rriten, në rast se Brukseli dëshiron të tregojë një përkushtim të vërtetë ndaj procesit të zgjerimit. Siç e shpjegon edhe analisti serb Dushan Reljic “gjatë viteve 2021-2027 Ballkanit Perëndimor do t'i jepen vetëm 500 euro për frymë”, një normë që nuk është sigurisht tregues i një angazhimi serioz me rajonin.

Për më tepër, BE-ja duhet të gjejë një zgjidhje të qëndrueshme ndaj dukurisë së migrimit të vazhdueshëm nga rajoni të njerëzve më të arsimuar, që i ka lënë shumë vende në Ballkan të varfëruara demografikisht dhe pa një potencial ekonomik.

Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, rreth 4.6 milionë njerëz janë larguar nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor midis viteve 1990-2019, ose rreth 25 për qind e popullsisë. Siç ndodh shpesh, individët që largohen jashtë vendit janë të rinj me arsim të lartë, me mendësi liberale, pra që mund të jenë një forcë shtytëse për afrimin e vendeve të tyre me një të ardhme më evropiane.

Por në vend të kësaj, siç argumenton Allison Carragher, ikja e vazhdueshme e tyre jahstë vendit (ku përfiton kryesisht Gjermania dhe Italia), po e

dëmton perspektivën e këtyre vendeve për t'iu bashkuar një ditë Bashkimit Evropian.

Së fundmi, BE-ja duhet të ketë një qëndrim më parimor dhe të ashpër përkundrejt Rusisë, e cila do të synojë të minojë vazhdimisht politikën evropiane në Ballkan, dhe të përfitojë nga çdo dobësi politike. Kjo vlen edhe për Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnje Hercegovinë (OHR), të cilën Rusia po përpjet hapazi që ta mbyllë.

Kjo zyrë u krijua nga Marrëveshja e Paqes e Dejtonit e vitit 1995, që i dha fund luftës në Bosnje. Që atëherë, OHR ka synuar të zbatojë aspektet civile të marrëveshjes së paqes, dhe të mbështesë krijimin e strukturave demokratike. Në vitin 2021, ish-Përfaqësuesi i Lartë, Valentin Inzko, e mbylli mandatin e tij 12-vjeçar.

Para se të largohej, ai nxiti miratimin e disa ligjeve që e dënojnë penalisht mohimin e gjenocidit, duke shkaktuar edhe përshkallëzimin e veprimeve nga separatistët serbë. Shumë serbë të Bosnjës, nuk e pranojnë ende gjenocidin që ndodhi në Srebrenicë në vitin 1995.

Vendimi i Inzkos, nuk dha ndonjë kontribut për lehtësimin e pajtimin ndëretnik dhe forcimin e strukturave demokratike. Për më tepër, ai shkaktoi një reagim të ashpër nga Rusia, e cila që atëherë është përpjekur që ta largojë këtë mision nga Bosnja.

Edhe pse OHR do të duhet të mbyllet si zyrë, përpara se Bosnja të anëtarësohet në BE, mënyra se si do të ndodhë kjo do të jetë vendimtare. Për të shmangur ri-ndezjen e

konfliktit etnik në Bosnje, BE-ja do të duhet të ushtrojë një kontroll të rreptë mbi procesin e pajtimin.

Edhe vëzhguesi më optimist në Perëndim, do të detyrohej ta pranonte se Rusia zotëron kapacitete për të nxitur konflikte dhe për ta destabilizuar seriozisht Ballkanin, një rajon me rëndësi të shtuar për arkitekturën e sigurisë së Evropës.

Duke nxitur mosmarrëveshje territoriale, duke mbështetur politikanët separatistë, dhe duke dëmtuar institucionet demokratike, rajoni mund të zhytet potencialisht në një gjendje kaotike, pa pasur nevojë që Kremli të dërgojë atje qoftë edhe një tank rus.

Prandaj është shumë e rëndësishme që BE-ja të ndjekë këshillën e famshme të Winston Churchill për të “mos lejuar asnjëherë që të shkojë dem një krizë e mirë”. Ajo duhet të përdorë vendosmërinë e saj të sapo-gjetur pas pushtimit rus të Ukrainës, për të formuluar një strategji më të qartë për Ballkanin.

Ofrimi ndaj 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor i një rrugë të qëndrueshme drejt anëtarësimit në BE, pas 18 vitesh ngecje në vend, do të ishte kundërveprimi i duhur ndaj përpjekjeve të Rusisë për të minuar përparimin që është bërë në rajon gjatë 3 dekadave të fundit.

Shënim: Margit Wunsch Gaarmann, studiuese në Institutin Gjerman për Çështjet Ndërkombëtare dhe të Sigurisë (SWP).

Si do të formohet superkontinenti i ardhshëm

Nga Richard FISHER

Gati 500 vjet më parë, hartografi flamand Gerardus Merkator krijoi një nga hartat më të rëndësishme të botës. Sigurisht, ajo nuk ishte përpjekja e parë për një atlas botëror, dhe as nuk ishte dhe aq e saktë. Aty mungonte Australia, dhe 2 Amerikat ishin paraqitur me përafërsi.

Që atëherë, hartografët kanë prodhuar versione gjithnjë e më të sakta, duke i korrigjuar gabimet e Merkator. Por harta e këtij të fundit, së bashku me të tjerat e prodhuara nga bashkëkohësit e tij të shekullit XVI-të, zbuluan një pamje vërtet globale të masave tokësore të Tokës.

Por ajo që nuk dinte Mercator, është se kontinentet nuk kanë qenë të vendosura gjithmonë në këtë mënyrë. Ai jetoi rreth 400 vjet përpara se të konfirmohej Teoria e Tektonikës së Pllakave. Kur sheh pozicionet e 7 kontinenteve në një hartë, është e lehtë të supozohet se ato janë fikse.

Për shekuj me radhë, qeniet njerëzore kanë luftuar dhe kanë bërë paqe mbi pjesën e tyre të këtyre territoreve, me supozimin se toka e tyre, por edhe ajo e fqinjëve të tyre, ka qenë gjithmonë, dhe do të jetë gjithmonë atje. Megjithatë nga

këndvështrimi i Tokës, kontinentet janë si gjetet që lëvizin nëpër një pellg.

Dhe të gjitha shqetësimet njerëzore, janë si një pikë shiu mbi sipërfaqen e gjetes. Të shtatë kontinentet ishin dikur të mbledhura në një masë të vetme, një superkontinent i quajtur Pangaea. Dhe para kësaj, ka prova për të tjera që shtrihen në një periudhë kohore prej mbi 3 miliardë vjet: Panotia, Rodinia, Kolumbia/Nuna, Kenorland dhe Ur.

Gjeologët e dinë se superkontinentet shpërndahen dhe mbledhen sërish bashkë sipas disa cikleve. Aktualisht jemi në gjysmë të rrugës. Atëherë si mund të jetë superkontinenti në të ardhmen? Ekzistojnë të paktën 4 skenarë të ndryshme, që tregojnë se një ditë qeniet e gjalla të Tokës, do të banojnë në një planet shumë të ndryshëm, që do të duket më shumë si një botë aliene.

Gjeologu Zhao Duarte i Universitetit të Lisbonës në Portugali, thotë se rruga për të eksploruar superkontinentet e ardhshme të Tokës, nisi me një ngjarje të pazakontë në të kaluarën. Një tërmet që e goditi Portugalinë mëngjesin e një të shtune në nëntorin e vitit 1755. Ai ishte ndër tërmetet më të fuqishme të 250 viteve të fundit, që vrau mbi 60.000 njerëz dhe

që shkaktoi një cunami që goditi deri përtej Oqeanit Atlantik. Ajo që e bëri veçanërisht të çuditshëm atë tërmet ishte vendndodhja e tij. “Në Atlantik nuk duhet të ketë tërmete të mëdha. Ai tërmet ishte vërtet i çuditshëm”-thotë Duarte.

Tërmetet e kësaj shkalle, ndodhin zakonisht në zonat kryesore të zhytjes, aty ku pllakat oqeanike zhyten nën kontinente, shkrihen dhe konsumohen në mantelin e nxehtë. Ky proces shkakton lëkundje të forta dhe shkatërrime të mëdha.

Por tërmeti i vitit 1755, ndodhi përgjatë një kufiri “pasiv”, ku pllaka oqeanike që qëndron nëntHEMELET e Atlantikut, kalon pa probleme në kontinentet e Evropës dhe Afrikës. Në vitin 2016, Duarte dhe kolegët e tij propozuan një teori për atë që mund të ndodhë.

“Qepjet” midis këtyre pllakave mund të zbërthehen, dhe mund të jetë e afërt një këputje e madhe. Nëse do të ndodhë vërtet, atëherë mund të krijohet një e çarë nga Mesdheu përgjatë Afrikës Perëndimore dhe ndoshta deri në Irlandë dhe Britaninë e Madhe, duke shkaktuar vullkane, ndërtime maresh dhe tërmete të forta në këto rajone.

Duarte thotë se kjo mund të çojë në mbylljen e Atlantikut. Dhe nëse do të vazhdonte të

mbyllet edhe Paqësori – gjë që tashmë po ndodh përgjatë “Unazës së Zjarrit” që e rrethon atë, do të formohej një superkontinent i ri. Ai e quajti atë Aurika, për shkak se në qendër të saj do të ndodheshin ish-masat tokësore të Australisë dhe Amerikës.

Më vonë Duarte hipotetizoi edhe skenarë të tjerë të ardhshëm. Bashkë me oqeanografin Matias Grin në Universitetin Bangor në Uells, e kuptuan se kishin nevojë për dikë që të krijonte disa modele dixhitale. Dhe ajo ishte kolegja e tij, Hana Dejvies, një tjetër gjeologe në Universitetin e Lisbonës.

Puna e tyre çoi në 4 skenarë. Përveç modelimit të një tabloje më të detajuar të Aurika-s, ata eksploruan edhe 3 skenarë të tjerë, secila i projektuar të ndodhë afro 200-250 milionë vjet nga tani. Skenari i parë ka të bëjë me atë që mund të ndodhë nëse vazhdon statuskuoja: Atlantiku qëndron i hapur dhe Paqësori mbyllet.

Në këtë skenar, superkontinenti që formohet do të quhet Novopangaea. Por mund të ketë edhe ngjarje gjeologjike në të ardhmen që të çojnë në rregullime të ndryshme. Një shembull është një proces i quajtur “ortoversion”, ku Oqeani Arktik mbyllet dhe Atlantiku dhe Paqësori mbeten të hapura.

Në mesin e oqeanit Atlantik, ka një kreshtë gjigante që përgjysmon dy pllakat kontinentale. Ajo kalon nga Islanda deri në jug të Atlantikut. Këtu po formohet litosfera e re, cila në fund mund të formojë një superkontinent të quajtur Pangea Ultima.

Modelet e superkontinenteve të ardhshme të Tokës, mund të shërbejnë edhe si një tregues për të kuptuar klimën e ekzoplaneteve. Për këtë të fundit 3 ekspertët bashkëpunuan me Majkëll Uej, fizikant në Institutin Godard të NASA-s për Studimet Hapësinore.

Modelimi i klimës së superkontinentit të ardhshëm nga Uej – që zgjati për disa muaj duke përdorur një superkompjuter – zbuloi disa ndryshime të habitshme midis 4 skenarëve. Për shembull Amasia, do të çonte në një planet shumë më të ftohtë sesa në skenarët e tjerë.

Me masën tokësore të përqendruar rreth Polin të Veriut dhe oqeanëve, që kanë më pak gjasa të bartin rrymatë të ngrohta në gjerësi gjeografike më të ftohta, do të krijoheshin shtresa akulli. Ndërkohë Aurika do të kishte një klimë më të butë dhe më të thatë, me brigje të ngjashme me ato të Brazilit të sotëm.

Marrë me shkurtime nga BBC – Bota.al





QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Gjilani shkarkon Munishin

Ismet Munishi është shkarkuar të hënën nga pozita e trajnerit nga skuadra e Gjilanit, pasi ky klub ka humbur hapin në garë për titull. Në anën tjetër, Munishi ka deklaruar se ndihet krenar që e ka drejtuar këtë klub dhe i a uruar suksese në garat evropiane

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 PRILL - Ismet Munishi nuk do të jetë më trajner i klubit nga Gjilani. Klubi nga Anamorava e ka shkarkuar trajnerin Munishi për mungesë të rezultateve të dobëta para përfundimit të kampionatit në Superligë. Gjilani pësoi humbje në fundjavë nga Dukagjini dhe ka

bërë një hap të madh në garën për titull, pasi tash Gjilani është nëntë pikë pas Ballkanit që është në pozitën e parë. "Sport Club 'Gjilani' njofton se ka mbyllur bashkëpunimin me shefin e shtabit teknik Ismet Munishi. Klubi e falënderon Munishin për kontributin e dhënë duke i uruar shumë suksese në karrierën e tij sportive. Ekipin do ta drejtoj Alban Hyseni deri



në fund të edicionit", thuhet në njoftimin e skuadrës së Gjilanit. Pas shkarkimit është deklaruar edhe trajneri Ismet Munishi. Ky i fundit ka thënë se është krenar për punën që ka bërë në klubin gjilanas.

"Prej ditës së parë deri më sot isha shumë krenarë që isha në bankinën e klubit të madh SC Gjilani! Falënderoj presidentin Florim Zuka për mundësinë dhe përkrahjen që ma dha tifozërinë 'Skifterat' që

së bashku ndamë gëzime e kohëve të fundit edhe hidhërimi për fat të keq. Kush me njeh e dinë se e bëj punën me zemër dhe përkushtohem 100%, por për fat të keq kjo nuk ishte e mjaftueshme që në të dalim kampion për çka edhe vendosëm t'i ndajmë rrugët. E falënderoj stafin për bashkëpunimin shumë të mirë që kishim dhe ju dëshiroj suksese në Evropë. Dhe në fund qershinë e kam për futbollistët e mi që i dua shumë dhe i lus të vazhdojnë me krenari, t'i mbrojnë ngjyrat e klubit të madh SC Gjilani", ka deklaruar Munishi.

Warriors shtyjnë kualifikimin, një fitore larg gjysmëfinaleve kampionët e Bucks

MILWAUKEE, 25 PRILL - Spektakli nuk ka munguar edhe në ndeshjet e katërta çerekfinale të "play-off" në NBA. Kampionët e Milwaukee u rikthyen te fitorja, duke mposhtur me rezultat 119-95 Chicago Bulls dhe udhëheqin 3-1 serinë e ndeshjeve në Lindje. Ndeshje e komanduar nga miqtë, ku Antetokounmpo realizoi 32 pikë e 17 rebound. Ai u mbështet edhe nga Allen me 27 pikë e Holiday me 26, në

një mbrëmje të përkryer për Bucks. 3-1 udhëheq në Lindje edhe Miami, skuadra që u rendit e para në sezonin e rregullt. Ekipi nga Florida mundi me shifrat 110-86 Atlanta jashtë fushe, në një ndeshje që e dominoi gjatë gjithë kohës. Të gjithë titullarët e Miami realizuan mbi 10 pikë, ku diferencën e bëri Butler, autor i 36 pikëve e 10 rebound. Në Perëndim, skuadra e Golden State pësoi ndalesën e parë në përballjen



ndaj Denver, me këta të fundit që fituan 126-121. Nikola Jokiq realizoi 37 pikë

për vendasit, mbështetur nga Morris me 24. Për Warriors u dalluan Curry me 33 pikë e Thompson me 32, por që s'mjaftuan. Golden State udhëheq 3-1 serinë. Ekuilibër në përballjen mes Phoenix dhe New Orleans, pasi tashmë seria është në barazpeshë 2-2. Pelicans shfrytëzoi në maksimum faktorin fushë, duke fituar 118-103 ndaj miqve. Ingram me 30 pikë ishte më i miri në parket për New Orleans.

KONFERENCA E LINDJES - ÇEREKFINALE "PLAY-OFF"

Miami - Atlanta	110-86 (3-1)
Philadelphia - Toronto	(3-1)
Milwaukee - Chicago	119-95 (3-1)
Boston - Brooklyn	(3-0)

KONFERENCA E PERËNDIMIT - ÇEREKFINALE "PLAY-OFF"

Phoenix - New Orleans	103-118 (2-2)
Dallas - Utah Jazz	(2-2)
Golden State - Denver	121-126 (3-1)
Memphis - Minnesota	(2-2)

Wladimir Klitschko paralajmëron rikthimin e madh në boks



KIEV, 25 PRILL - Wladimir Klitschko ka paralajmëruar se mund ta bëjë një rikthim të bujshëm në boks, por vetëm kur lufta në Ukrainë të ketë mbaruar dhe vendi i tij të mos kërcënohet më nga Rusia. Ish-boksieri ukrainas ishte kampion bote në kategorinë e peshave të rënda për 11 vjet. Ai doli në pension në gusht të

vitet 2017 pas humbjes së pësuar në meçin me Anthony Joshua në fillim të atij viti. Klitschko së fundi vendosi t'i bashkohet ushtrisë ukrainase në luftën kundër agresionit rus. Megjithatë, në një intervistë për gazetën gjermane "BILD" pas fitores së Tyson Furyt ndaj Dillian Whytet të shtunën mbrëma,

Klitschko thotë se nuk e ka përjashtuar mundësinë e rikthimit në ring. "Mësova gjithashtu se pavarësisht luftës, nuk duhet ta harrosh jetën. Sporti është pjesë e jetës sime. Jam i kënaqur që fitoi Tyson Fury", ka thënë ai. "Kush e di, nuk dua të premtoj asgjë të madhe këtu. Por, nëse jam në formë të

mirë dhe mbi të gjitha, nëse lufta në Ukrainë së shpejti do të marrë fund dhe se kufijtë tanë ekzistojnë pa asnjë kërcënim nga Rusia, atëherë kush e di?", ka shtuar ai. 46-vjeçari e mbylli karrierën me 69 meçe në boks profesionist, me bilanc prej 64 fitoreve e 5 humbjeve. 53 prej fitoreve i arriti me nokaut.

Prishtina në finale, fiton edhe ndeshjen e dytë ndaj Trepçës

PRISHTINË, 25 PRILL - Prishtina është kualifikuar në finale të plejofitit në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Prishtina e ka fituar edhe ndeshjen e dytë gjysmëfinale ndaj Trepçës. Të dielën

mbrëma në "Minatori", Prishtina fitoi me rezultat 38:32. Vetëm fillimi i ndeshjes u ka takuar vendasve. Më pas Prishtina nisi shpëtimin gradual dhe në pushim shkoi me avantazh prej pesë golave,

17:12. Në pjesën e dytë mysafirët kanë kontrolluar ndeshjen dhe fitorja e tyre nuk është rrezikuar asnjëherë. Oltion Beshiri me 11 gola ishte më efikas te Prishtina. 7 i realizoi Agon Bajqinovci, ndërsa

5 i kishte Lulzim Shabani. Te Trepça u dallua Sali Maxhera me 9 gola. 6 i kishte Shpëtim Mehmeti, ndërsa 5 gola i realizoi Muhamet Dubovci. Në finale të plejofitit takohen Besa Famgas e Prishtina.



32 vjet nga ndarja fizike e vëllait tonë



Fadil (Nebih) VATA

(03.01.1962 – 25.04.1990)
(Hero i Kosovës)

“I ri me moshë mirëpo i pavdekshëm me vepra. Vepra jote atdhetare ishte shembull frymëzimi për të gjithë ata që luftuan për lirinë e Kosovës. Për gjeneratat e ardhshme jeni shembull i idealistit, guximtarit dhe dijetarit, që nuk kurseu asgjë në të mirë të Atdheut. Jemi krenarë që të kemi udhërrëfyes në jetën tonë, për të jetuar dhe punuar me nderë për Atdhe”./ Familja Vata

Me mall dhe krenari: vëllezërit Rama dhe Florimi, motrat Mehremja, Vezirja, Merita dhe Kastriotja, kunatat Imranja dhe Sabrija, Rina, nipat Atdheu, Arbëri, Fadili, mbesat Urata, Mjalta dhe stërmbesa Eva.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Toska" SH.P.K. me pronar Arben Toska Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues 811187857 nrb: 71339297 nr. fis: 601713911 ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Toska" D.O.O. Arben Toska Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik Identifikues 811187857 nrb: 71339297 nr. fis: 601713911 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Toska" L.L.C. Arben Toska Gjilan, has come to the decision to quit its business: nr. Unik Identifikues 811187857 nrb: 71339297 nr. fis: 601713911 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo

**Njoftim për tatimpagues****Pajisu me PEF/SF dhe lësho Kuponë Fiskal!**

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat, të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor aty ku nuk kërkohet të lëshohet faturë tatimore, janë të obliguar që të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale (PEF), gjegjësisht Sistem Fiskal dhe të lëshojnë Kuponë Fiskal.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen te tatimpaguesit, të cilët:

- Kërkohej të fiskalizohen, por nuk janë të pajisur me PEF/SF;
- Janë të pajisur me PEF/SF, por nuk lëshojnë Kuponë Fiskal;
- Lëshojnë kuponë jo-fiskal dhe përdorin pajisje jo-fiskale.



Disa nga veprimtaritë, si: tregti, prodhim, shërbim, shëndetësi, hoteleri, arsim, transport, artistike-zbavitëse, etj. nuk zbatojnë këtë obligim, prandaj ATK, u bënë thirrje që të pajisen me PEF/SF dhe të lëshojnë Kuponë Fiskal.

ATK, inkurajon të gjitha kategoritë e lartpërmendura që t'i përgjigjen në mënyrë të saktë kërkesave ligjore, në të kundërtën do të aplikohen ndëshkimet administrative, ashtu siç janë përcaktuar me legjislacionin tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

Krijoj mirëqenie të përgjithshme, merr Kuponin Fiskal!

Administrata Tatimore e Kosovës

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Lumrije Mula nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

► Ardijan Gjini nga Doblilbare, Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. "Vëllezërit Lleshi" nga klasa e -I- deri në të -VIII-tën.

► Haki Ramadani shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Burim Selmani shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Leonor Vehapi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Ekrem Rexha 'Drini'" Lubizhdë

► Milazim Sallauka shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Rami Braha shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Argjent Neziri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl, dhjetë , njëmbëdhjetë dymbëdhjetë dhe diplomën e SH.M.T. "Nexhmedin Nixha".

► Endrit Shabani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjet njëmbëdhjetë dymbëdhjetë të SH.M.L. Teknike "Nexhmedin Nixha".

► Agim F. Jaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha".

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

